

AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "EmpoMidas" SH.P.K

Sot më 07.06.2021 u paraqitën palët e mëposhtme :

- Mexhit Cuka, lindur në Tiranë më 13.05.2002, me numër personal K205130251

Të cilat kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti së cilës i beshkëngjitet.

NENI 1 – EMËRTIMI

Emërtimi i shoqërisë është "EmpoMidas" Sh.p.k

NENI 2 – SELIA

Selia e shoqërisë është në Tiranë, rruga Shyqyri Ishmi, pallati 79/1, sh 1, kati 3, apartamenti 8.

NENI 3 – KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

NENI 4 – OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria do të merret me marketing dhe publikime online, ndërtim dhe mirëmbajtje webi, konsulencë biznesi, mirëmbajtje sistemesh shitje online

4.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë sipas nenit 3.1 të statutit apo nenit 4.1 të Aktit të Themelimit.

NENI 5 – KAPITALI THEMELTAR

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1 000 000 lekë.

5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuote, të gjitha të nënshkruara me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë përcaktuar në nenin 7 të statutit të saj.

NENI 6 – KONTRIBUTET

6.1 Kontributi në kapitalin themeltar të shoqërisë është ofruar si më poshtë :

- Mexhit Cuka ofron një kontribut në para të barabartë me 1 000 000 lekë.

6.2 Sipas kontributeve të mësipërme :

- Personit Mexhit Cuka i përket një kuotë me vlerë nominale 1 000 000 lekë që korrespondon me 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 7 – TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat i transferohen të dytëve dhe të tretëve sipas parashikimeve të statutit.

NENI 8 – ADMINISTRIMI

8.1 Me këtë akt emërohet një administrator i shoqërisë, si më poshtë :

- Z. Mexhit Cuka, djali i Ahmet Cuka, lindur më 13/05/2001, me numër personal K205130251.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe nenit 14 të statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim administratori mund tu drejtohet për ndihmë palëve të treta për cilëndo çështje e cila ka të bëjë me veprimtarinë e shoqërisë.

8.4 Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të shoqërisë në formim e sipër, deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ai është i autorizuar të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë ti delegojë kompetencat e tij, personave të tjerë.

Tiranë më 07/06/2021

ORTAKËT

MEXHIT CUKA


